



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1373 / Prot
3

Tiranë, më 07 / 8 / 2021

VENDIM

Nr. 44, datë 07 . 8 . 2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1373 Prot., datë 10.08.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A.” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit nëpërmjet shkresës së datës 05.08.2021, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si më poshtë:

1. *Emrat dhe pozicionin përkatës të të gjithë punonjësve aktualë pranë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.*

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 09.08.2021, ka kthyer përgjigje duke argumentuar se: “...baza ligjore e përdorur në kërkesë është e gabuar dhe në shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, pasi:

- *Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., është shoqëri aksionere, e cila është themeluar dhe ushtron veprimtarinë e saj, bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në këtë kontekst, asnjë prej të punësuarëve në këtë shoqëri nuk kryen funksione shtetërore, për të cilën i jeni referuar nenit 23 të ligjit*

nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ndërkohë, që nenet 48 dhe 56 të ligjit themeltar të shtetit, nuk kanë asnjë lidhje me përmbajtjen e kërkesës tuaj.

- Cënon parimet bazë të detyrueshme për zbatim nga çdo institucion apo person juridik, referuar ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
- Informacioni i kërkuar nuk ka lidhje me interesin publik, në zbatim të të cilit është ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Ankuesi, pas refuzimit të dhënies së informacionit nga ana e Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 1373/1 prot., datë 12.08.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit, brenda datës 19.08.2021.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. K-1838/1 Prot., datë 19.08.2021, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me shkresën nr. 1373/2 Prot., datë 19.08.2021, ka kthyer përgjigje duke mbajtur të njëjtin qëndrim sipas e-mail-it datë 09.08.2021. Gjithashtu, ka bërë më dije se, bazuar në pikën 3, të nenit 7 të "*Regullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime sh.a.*" përcaktohet se: "*Qëllimi i përpunimit të të dhënave personale të personelit të UKT-së është për efekt të krijimit të marrëdhënies së punës e përmbushjes së detyrimeve për administrimin e dosjeve personale të punonjësit*" dhe në funksion të saj në nenin 19 citohet se: "*Të dhënat personale të përpunuara për denoncuesit e subjekteve të kontrolluara, personelin e UKT-së dhe vizitorë, gëzojnë mbrojtjen sipas ligjit dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera të ndryshme nga ai i grumbullimit të tyre*".

Pas konsultimit të legjisllacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk janë në përputhje me parashikimet e LDI dhe

Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, (në vijim, “Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit: “...Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., është shoqëri aksionere, e cila është themeluar dhe ushtron veprimtarinë e saj, bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në këtë kontekst, asnjë prej të punësuarëve në këtë shoqëri nuk kryen funksione shtetërore, për të cilën i jeni referuar nenit 23 të ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,...”, Zyra e Komisionerit vlerëson se, nuk qëndron.

Bazuar në nenin 1 të ligjit të LDI, përcaktohet qartë se, ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike.

Referuar pikës 1 të nenit 2 të LDI, “Autoritet publik”: a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Nga verifikimi i kryer në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, rezulton se Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., (në vijim “UKT sh.a.”), është shoqëri aksionere, me pjesëmarrje të aksioneve 100% nga Bashkia Tiranë. Gjithashtu, në pikën 1 të nenit 1 të statutit të UKT sh.a., përcaktohet se: “Shoqëria aksionere ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të bashkisë aksionere të saj”, ndërsa në pikën 3 të nenit 4 të tij, kapitali i shoqërisë zotërohet në masën 100% nga aksioneri i vetëm Bashkia Tiranë.

Pra, nga sa më sipër, rezulton se UKT sh.a. është një shoqëri tregëtare me aksione publike, që ushtron funksione publike, me objekt të veprimtarisë së saj përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatoreve. Për rrjedhojë, UKT sh.a. është Autoritet Publik në kuptim të LDI dhe detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Po ashtu, në kundërshtim me argumentin sa pretendohet, statuti i UKT sh.a, si subjekt i ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” është pranuar dhe nga vet Autoriteti Publik nëpërmjet zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në nenet 6, 7, 8 dhe 10 të këtij ligji, reflektuar në faqen e tyre zyrtare në internet <http://ujesjellesitirane.al/programi-transparencës/>.

Lidhur me argumentin e citur në përgjigjen e Autoritetit Publik, se informacioni i kërkuar ...Cënon parimet bazë të detyrueshme për zbatim nga çdo institucion apo person juridik,

referuar ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar", sqarojmë se: në parim, e drejta e aksesit në të dhënat personale sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është një e drejtë që gëzohet nga subjekti i të dhënave personale. Në rastin konkret, kërkesa për informacion e paraqitur nga ankuesi bazohet në LDI dhe në nenin 17 të tij jepen rastet e kufizimit të dhënies së informacionit, ku një nga kufizimet është edhe ruajtja e jetës private.

Në këto kushte, duke qenë se në kërkesë bëhet fjalë për funksionar publik *emrat dhe pozicionet e punonjësve aktualë të Autoritetit Publik*, ekziston një përjashtim referuar shkronjës b) të pikës 4 të nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin parashikohet se "Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre".

Përsa i përket qëndrimit të mbajtur nga Autoriteti Publik se: "...bazuar në pikën 3, të nenit 7 të "Regullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime sh.a." përcaktohet se: "Qëllimi i përpunimit të të dhënave personale të personelit të UKT-së është për efekt të krijimit të marrëdhënies së punës e përmbushjes së detyrimeve për administrimin e dosjeve personale të punonjësit" dhe në funksion të saj në nenin 19 citohet se: "Të dhënat personale të përpunuara për denoncuesit e subjekteve të kontrolluara, personelin e UKT-së dhe vizitorë, gëzojnë mbrojtjen sipas ligjit dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera të ndryshme nga ai i grumbullimit të tyre" Komisioneri vlerëson se është i gabuar. Regullorja e brendshme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale është detyrim për Kontrolluesit apo Përpunuesit e të Dhënave, që buron nga neni 27 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, për çdo kategori subjekti të dhënash. Por, theksoj se në asnjë moment rregullat e vendosura në Rregullore nuk mund të vijnë në kundërshtim me parashikimet e LDI dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik". Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar. Çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e "prodhuesit" apo "mbajtësit" të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Gjithashtu, bazuar në nenin 7, pika 1, shkronja d të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Konkretisht dispozita e sipërcituar përcakton se: *“Në përputhje me programin e transpanrencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime”.*

Nga sa më sipër, Autoriteti Publik jo vetëm duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion, por në zbatim të nenit 7 të LDI, duhet që informacionin e kërkuar ta bëj publik në mënyrë proaktive në programin institucional të transparencës.

LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. Në këtë kontekst në lidhje me të njëjtën kërkesën për informacion, Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve, konkretisht në vendimin nr. 23 datë 13.04.2021; vendimin nr. 21, datë 09.04.2021 dhe vendimin nr. 32, datë 10.07.2018.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

Bazuar në pikën 1, të nenit 18 të LDI, parashikohet se *mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative.* Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se *veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë personat përgjegjës.*

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1373 Prot., datë 10.08.2021, të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A.”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 05.08.2021, konkretisht: “Emrat dhe pozicionin përkatës të të gjithë punonjësve aktualë pranë Ujësjellës Kanalizime Tiranë”, brenda datës 14 . 9 .2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 07 . 9 .2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

